



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2018

V E N D I M

Nr. 55, Datë 13/02/2018

Mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 75, datë 26.07.2016, e Znj. N. B., asistuar nga “Qendra për Nisma Ligjore Qytetare”, ku pretendohet diskriminim për shkak të racës¹, ngjyrës, etnisë, gjendjes ekonomike dhe strehimit nga ana e Shtëpisë së Fëmijës Shkollor Shkodër, Shërbimit Social Shtetëror, Bashkisë së Shkodrës dhe Bashkisë së Tiranës.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

A. Parashtrimi i fakteve, sipas subjektit ankues

Ankuesja N. B., përmes ankesës së saj pretendon diskriminim për shkak të racës, ngjyrës, etnisë, gjendjes ekonomike dhe strehimit, nga ana e Shtëpisë së Fëmijës Shkollor Shkodër, Shërbimit Social Shtetëror, Bashkisë së Shkodrës dhe Bashkisë së Tiranës. Ajo i përket komunitetit rom dhe është asistuar në përgatitjen e ankesës nga “Qendra për Nisma Ligjore Qytetare”, në Tiranë. Referuar çertifikatës familjare, ankuesja është nënë e 7 (shtatë) fëmijëve, tre prej të cilëve, vajza. ndodhen për rritje dhe edukim pranë Shtëpisë së Fëmijës Shkollor Shkodër. Ankuesja N. B. pretendon se kushtet në të cilat ndodhet, papunësia dhe mungesa e strehimit e kanë vendosur atë në pozitat e diskriminimit të tërthortë, sepse janë bërë pengesë që ajo të takojë dhe marrë vajzat e saj qoftë edhe përkohësisht, gjë e cila nuk i është lejuar. Sipas saj, zbatimi i aktit nr. 1963 prot,

¹ Ankuesja i përket komunitetit rom

datë 18.09.2015, i Shërbimit Social Shtetëror nga Shtëpia e Fëmijës Shkollor Shkodër, është një tjetër pengesë, që i ka mohuar të drejtat e saj si nënë dhe kujdestare ligjore e vajzave të saj. Në ankesë ankuesja sqaron se ka aplikuar pranë Bashkisë së Tiranës, për trajtim me strehim, sipas programit të banesave sociale me qera, provuar me shkresën nr. 12983 prot, datë 17.06.2016, por pretendon se ende nuk ka marrë përgjigje nga ky institucion. Më datën 20.07.2016, përmes një ankese drejtuar Ministrit të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, ajo i ka kërkuar këtij të fundit:

- Që t'i mundësohet një banesë, me qëllim që të mund të marrë përkohësisht vajzat e saj në familjen biologjike, të cilat kanë tre vjet që janë sistemuar në Shtëpinë e Fëmijës Shkollor Shkodër;
- Mbështetje që t'i sigurohet një punë, e cila do ta ndihmojë në marrjen e përhershme të vajzave;
- Rekomandim për Bashkinë e Tiranës, me qëllim që kjo e fundit të marrë në konsideratë kërkesën e saj për të përfutur nga program i banesave sociale.

Sipas saj, Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë i kishte premtuar se shumë shpejt do t'i jepte një banesë, që të mund të rikthente sërish në familjen biologjike vajzat e saj². Ankuesja ngre pretendimin se gjendja psikologjike e vajzave që jetojnë në Shtëpisë së Fëmijës Shkollor Shkodër është e rënduar, ndaj ato kërkojnë me ngulm të bashkohen me nënën e tyre, por mungesa e strehimit dhe punësimit është pengesa kryesore, që pengon bashkimin e saj me fëmijët. Znj. N. B. deklaron se shkak që nuk i sigurohet strehim dhe nuk i kthehet përgjigje, lidhur me aplikimin e saj, është pikërisht fakti se ajo i përket komunitetit rom, ndaj ndihet e diskriminuar nga Bashkia e Tiranës.

B. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat proceduralë të ndjekur nga Komisioneri, vijnë si më poshtë:

Pas analizimit të ankesës nr. 75, datë 26.07.2016 të Znj. N. B. u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi". Për këtë arsye, Komisioneri filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- ✚ Mbështetur në nenin 33, pika 7, të ligjit nr. 10 221/2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", Komisioneri, me anë të shkresës nr. 751/1 prot, datë 28.07.2016, fillimisht iu drejtua ankueses, pasi u konstatua se ishte e nevojshme që Znj. N. B. duhet të jepte informacion plotësues, mbi aplikimin e saj për punësim pranë Zyrës Rajonale të Punësimit, si dhe aktet përkatëse që vërtetonin gjendjen e saj shëndetësore, për të gjitha diagnozat që ajo pretendonte në ankesë.

² Shkresë e ankueses nr. 751/3, datë 09.08.2016

- Në përgjigje të shkresës nr. 751/1 prot, datë 28.07.2016, të Komisionerit, ankuesja dërgoi formularin e ankesës të plotësuar sipas rubrikave respektive. Në ankesë sqarohet se me pëlqimin e saj³, për arsye të pamundësisë për t'i mbajtur, pasi është e papunë dhe pa shtëpi, të tri vajzat e saj janë sistemuar në Shtëpinë e Fëmijës Shkollor, Shkodër, në datën 10.09.2013. Më parë ato kanë qenë të sistemuara në Shtëpinë e Fëmijës Parashkollor 3-6 vjeç, me Urdhër Pranimi të Shërbimit Social Shtetëror Tiranë, nr. 376/1 prot, datë 18.03.2011.

- Ankuesja depozitoi në cilësinë e provës disa përshkrime dhe ekzaminime mjekësore, ndërsa rreth aplikimit për punësim, përmes zyrave rajonale të punësimit, ankuesja nuk paraqiti ndonjë dokument.

✚ Në mbështetje të ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma a)⁴, nenit 32 pika 2⁵ dhe nenit 33 pika 7⁶, përmes shkresës nr. 751/4 prot, datë 12.08.2016, Komisioneri i është drejtuar për informacion Shërbimit Social Shtetëror (institucion në varësi të Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë), Bashkisë Shkodër dhe Shtëpisë së Fëmijës Shkollor Shkodër.

- Në përgjigje të shkresës nr. 751/4 prot, të datës 12.08.2016, së Komisionerit, Shërbimi Social Shtetëror ka dërguar shkresën nr. 1816/1 prot, datë 02.09.2016, ku informon se veprimet e Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Shërbimit Social Shtetëror janë në përputhje dhe në zbatim të legjislacionit në fuqi, përkatësisht të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”; Ligjit 9355/2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, (i ndryshuar) dhe Ligjit 10433/2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. Ata kanë hedhur poshtë pretendimet e ankueses, me argumentet si më poshtë vijnë:

- Nga verifikimi në regjistrin elektronik të ndihmës ekonomike, në Njësinë Administrative nr. 6 të Bashkisë së Tiranës, familja N. B. trajtohet me pagesë, ndihmë ekonomike 4500 lekë në muaj, ndërsa 4 fëmijët e saj trajtohen me pagesën e Statusit të Jetimit me 3000 lekë x 4 fëmijët = 12 000 lekë.
- Referuar informacioneve nga ARSIS-Organizatë Shoqërore e Përkrahjes së të Rinjve, Dega Shqipëri⁷, familja N. B. është ndihmuar dhe mbështetur për vite me radhë me ndihmë përkundrejt punësimit të anëtarëve të familjes dhe mos abuzimit me fëmijët që i nxjerr për lypje.

³ Mbështetur ne deklaratë noteriale.

⁴Neni 32, pika 1, gërma a) “të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj”

⁵ Neni 32, pika 2 “Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin komisionerin në përmbyshjen e detyrave të tij, veçanërisht duke i dhënë informacionin që i nevojitet atij”

⁶Neni 33, pika 7 “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacion edhe nga çdo person ose burim tjetër”

⁷ Shkresë nr. 102 prot, datë 29.08.2016 e ARSIS, drejtuar Shërbimit Social Shtetëror;

- Në vitin 2015 i është ofruar punësim për fëmijët madhorë, nëpërmjet zyrës së punësimit (Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social), por ata nuk janë paraqitur.
- Në vitin 2016, familja N. B. është mbështetur me pagesën e qerasë së shtëpisë nga ARSIS për një muaj.
- Aktualisht familja N. B. është në pritje të vendimit të Këshillit të Bashkisë Tiranë për strehim, pasi ankuesja ka aplikuar për strehim pranë kësaj bashkie.

- Nëpërmjet shkresës nr. 11189 prot, datë 08.09.2016, Bashkia Shkodër e informon Komisionerin se në zbatim të planit lokal të veprimit për fëmijët në situatë rrugë, familja N. B. është identifikuar në situatë rruge, bashkë me fëmijët e saj, duke ushtruar aktivitetet prej vitesh në qytete të ndryshme të Shqipërisë⁸. Për këtë arsye kjo familje është vënë në dije të shkeljeve ligjore, duke vlerësuar ndërprerjen urgjente të aktivitetit të nxjerrjes së fëmijëve në rrugë dhe duke e referuar dy herë rastin pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Shkodër, për kryerjen e veprimeve hetimore e procedurale për dokumentimin e veprës penale të keqtrajtimit të fëmijëve, prashkuar në nenin 124/b të Kodit Penal⁹. Nëpërmjet shkresës nr. 6703, datë 02.06.2016, ky institucion i është drejtuar për bashkëpunim Njesisë Administrative nr. 6 në Tiranë, Drejtorisë së Mbrojtjes Sociale në Bashkinë e Tiranës dhe Agjensisë Shtetërore të Mbrojtjes së Fëmijëve në Tiranë, ku u ka kërkuar marrjen e masave për largimin e fëmijëve nga rruga.

- Shtëpia e Fëmijës Shkollor Shkodër e informon Komisionerin, se ka vepruar duke u mbështetur në shkresën nr. 1963 prot, datë 18.09.2015, e Shërbimit Social Shtetëror, e cila u është referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 658, datë 17.10.2005 “Për standardet e Shërbimeve Shoqërore”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 659, datë 17.10.2005 “Për standardet e Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror për fëmijët e institucioneve rezidenciale”, ku ndër të tjera citohet: *“Kur fëmijët janë në kujdestari ligjore të prindërve, por marrin shërbim në Qendër Përkujdesi, ata mund të largohen nga institucioni si në periudhë të përkohshme, por dhe të përhershme, vetëm në rastet kur vlerësimi social ekonomik i kryer nga NJMF/administrator shoqëror parashtrohet për mirësim të kushteve të familjes biologjike.....”*.

- ✚ Duke patur parasysh faktin se Znj. N. B. është banore e qytetit të Tiranës, përkatësisht në Njësinë Administrative Nr. 6, Komisioneri iu drejtua Bashkisë së Tiranës, nëpërmjet shkresës nr. 751/2, datë 28.07.2016, për t’u informuar mbi aplikimin e Znj. N. B. për strehim dhe pretendimeve të saj për diskriminim nga ana e kësaj bashkie, për shkak se i përket komunitetit rom.

- Nëpërmjet shkresës nr. 23527/1, datë 22.08.2016, Bashkia e Tiranës ka bërë me dije Komisionerin se *“Trajtimi i të pastrehëve në qytetin e Tiranës, realizohet në bazë të ligjit të strehimit nr. 9232/2014 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”. Znj. N. B. figuron të jetë regjistruar pranë Njesisë Administrative nr. 6, për t’u trajtuar me strehim, sipas*

⁸ Referuar shkresës nr. 6703 prot, datë 02.06.2016 dhe shkresës nr. 10048 prot, datë 12.08.2016, së Bashkisë Shkodër;

⁹ Shkresë e Bashkisë Shkodër nr. 11189 prot, datë 08.09.2016;

programit të banesave sociale me qera, duke plotësuar fazën e parë të aplikimit. Më pas ajo si aplikante figuron të ketë mangësi në dokumentacion, gjë që ka përjashtuar të drejtën e paraqitjes së dosjes në Komisionin Paraseleksionues të Strehimit dhe më pas në Këshillin Bashkiak”. Nëpërmjet shkresës nr. 16979/1 prot., datë 13.06.2016, Bashkia ka hedhur poshtë pretendimet e Znj. N. B. për diskriminim, për shkak se i përket komunitetit rom, duke theksuar se “Strehimi është prioritet i Bashkisë dhe se Komisioni i Strehimit ka vlerësuar 160 familje nga komuniteti rom dhe egjitian për të përfituar nga banesat sociale”.

✚ Në vijim të procedurave hetimore, Komisioneri vendosi që më datën 19.09.2016 të realizojë një seancë dëgjimore, ku palët u ftuan të merrnin pjesë për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë pretendimet e tyre.

- Znj. N. B. përfaqësohej nga avokatë të “Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare”, të cilët pretenduan se ankuesja po vuan pasojat e diskriminimit të tërthortë, për shkak të gjendjes së dobët ekonomike, pasi është e pastrehë dhe e papunë. Njëkohësisht, u theksua fakti se Znj. N. B. po përballëj me pasojat e zbatimit, nga ana e Shtëpisë së Fëmijët Shkollor Shkodër, **të aktit nr. 1963 prot, datë 18.09.2015, të Shërbimit Social Shtetëror, “Kujtesë për drejtuesit e institucioneve rezidenciale për fëmijë”**, i cili e pengonte atë e në mënyrë të tërthortë dhe i mohonte të drejtën për takuar dhe për të marrë qoftë edhe përkohësisht vajzat e saj. Sipas tyre, mungesa e kushteve e ka ekspozuar Znj. N. B. përballë diskriminimit të tërthortë nga ana e Shtëpisë së Fëmijës Shkollor Shkodër, Shërbimit Social Shtetëror dhe e Bashkisë së Tiranës, ndërkohë që sipas tyre, institucionet duhet të punojnë për fuqizimin e familje dhe jo dobësimin e saj.

- Të pyetur nga Komisioneri, lidhur me procedurat që zbatohen nga ana e Shtëpisë së Fëmijës Shkollor Shkodër, për pranimin e fëmijëve në këtë qendër, përfaqësuesit e kësaj qendre sqaruan se ato mbështeten në Vendimin Nr. 425, datë 27.6.2012, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale, publike dhe jopublike, të përkujdesjes shoqërore” (i ndryshuar)¹⁰, sipas së cilës pranimi bëhet me kërkesën e prindit, e cila më pas shqyrtohet nga një grup multidisiplinor dhe është pikërisht ky i fundit që vendos për pranimin ose jo të fëmijës. Në rastin konkret, vetë ankuesja, mbështetur në një deklaratë noteriale, ka kërkuar që 3 vajzat e saj, për shkak të pamundësisë ekonomike dhe për t’u siguruar kushte më të mira jetese, ka pranuar që t’i lërë në një qendër rezidenciale. Të pyetur nga Komisioneri mbi pamundësinë e marrjes së fëmijëve nga nëna e tyre, qoftë edhe përkohësisht, ata i janë përgjigjur me argumentin se: “kërkesa është refuzuar, pasi Znj. N. B. nuk ka paraqitur asnjë dokument që të provojë se i plotëson kushtet për marrjen e fëmijëve. Në rastet kur ne e kemi lejuar nënën që të marrë fëmijët e saj, madje t’i mbante edhe një ditë më shumë, rezulton se Znj. N. B. nuk i ka respektuar afatet e kthimit të tyre në institucion, me pretendimin se vajzat nuk dëshirojnë më të kthehen aty”¹¹.

¹⁰ Ndryshuar me VKM nr.839, datë 3.12.2014; nr.106, datë 15.2.2017;

¹¹ Proçes-verbal nr. extra prot, datë 10.05.2016;

- Përfaqësuesit e Shërbimit Social Shtetëror kanë kundërshtuar pretendimet e ankueses për diskriminim. Sipas tyre, ata nuk i kanë kufizuar asnjëherë ankueses të drejtën për shërbim dhe nuk e kanë trajtuar ndryshe në krahasim me të njëjtën kategori. Përsa i përket aktit nr. 1963 prot, datë 18.09.2015, nxjerrë nga ky institucion, ata sqaruan se Shtëpia e Fëmijës Shkollor Shkodër nuk është në varësi të Shërbimit Social Shtetëror. Lidhur me pretendimet e ankueses ndaj këtij institucioni, përfaqësuesit e tij theksuan se fuqizimi i familjeve vjen në zbatim të dispozitave ligjore dhe nuk është kompetencë e Shërbimit Social Shtetëror që të plotësojë kushtet e as të bëjë kërkesë për pranimin e fëmijëve në një qendër rezidenciale. Shërbimi ndërhyr për të vendosur fëmijët nga rrethet e tjera, diku tjetër, në bazë të vlerësimit të Komisionit Multidisiplinar. Të pyetur nga Komisioneri rreth çështjes së lobimit me aktorët e tjerë, me qëllim punësimin e Znj. N. B., ata sqaruan se ankuesja është udhëzuar dhe është referuar drejt Zyrave Rajonale të Punësimit, ku ajo është regjistruar si e papunë. Sipas tyre, këta të fundit i kanë ofruar mundësi për punësim, por ankuesja ka refuzuar duke deklaruar se *“nuk mund të punoj, pasi jam e sëmurë”*. Në këto kushte, Shërbimi Social Shtetëror e ka referuar rastin për të marrë mbështetje sociale.

- Përfaqësuesit e Bashkisë së Shkodrës, mbështetur në vlerësimin e bërë për fëmijët në situatë rruge, ka identifikuar se fëmijët e familjes N. B. punojnë në mbledhjen e mbetjeve të riciklueshme. Në zbatim të ligjit nr. 10347, datë 04.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve” dhe Udhëzimit nr.10/2015 “Udhëzues i procedurave për identifikimin, ndihmën e menjëhershme dhe referimin e rasteve”, kjo familje është referuar dy herë pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Shkodër *“Për kryerjen e veprimeve hetimore e procedurale për dokumentimin e veprës penale të keqtrajtimit të fëmijëve, parashikuar në nenin 124/b të Kodit Penal dhe se është vënë në dije të shkeljeve ligjore, duke vlerësuar ndërprerjen urgjente të aktivitetit të nxjerrjes së fëmijëve në rrugë”*.

✚ Ndërkohë që, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi po shqyrtonte administrativisht ankesën nr. 75, datë 26.07.2016, e Znj. N. B., çështja me objekt-kthimin e fëmijëve të Znj. N. B., pranë familjes biologjike u gjykua nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, e cila nëpërmjet vendimit nr. 1449 (5224), datë 01/12/2016, ka vendosur kthimin e fëmijëve të ankueses pranë familjes biologjike. Nëpërmjet këtij vendimi janë ngarkuar Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Tiranë, Shërbimi Social Shtetëror (Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve Tiranë) dhe Njësia Bashkiake nr. 6, Tiranë për të monitoruar për një vit nga marrja formë të prerë të vendimit paditësen N. B. dhe fëmijët e mitur Kamela N. B. dhe Laura N. B..

Në vitin 2017, ankuesja N. B. ka paditur sërish Shtëpinë e Fëmijës Shkollor Shkodër pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, ku ka kërkuar detyrimin e palës së paditur të paguajë dëmshpërblim për ushtrimin e diskriminimit ndaj saj në shumën 50.000 lekë. Pas

gjykit të çështjes, nëpërmjet vendimit nr. 515 (613), datë 18.07.2017, kjo gjykatë ka vendosur rrezimin e kërkesëpadisë së Znj. N. B., si të pabazuar në ligj e në prova.

Në paragrafin 3, të nenit 36, të Kodit të Procedurës Civile parashikohet shprehimisht: *“Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata”*. Në këtë kontekst, vihet re qartë qëndrimi i ligjvënësit, ku juridiksioni gjyqësor prevalon mbi atë administrativ. Si pasojë, duke qenë se gjykatat e sipërpërmendura janë shprehur mbi objektin e ankesës së Znj. N. B., Komisioneri gjykon se shqyrtimi administrativ i ankesës së saj, duhet të pushojë.

Pavarësisht sa më sipër, duke iu referuar shkresës nr. 1963, datë 18.09.2015, të Shërbimit Social Shtetëror, drejtuar institucioneve rezidenciale për fëmijë, Komisioneri gjykon se duhen parashikuar opsione më të zbutura dhe duhet treguar më tepër fleksibilitet, në rastet kur prindërit, kërkojnë largimin në mënyrë të përkohëshme të fëmijëve të tyre, që kanë në kujdestari ligjore, por që marrin shërbim në Qendër Përkujdesi. Referuar pikës 3 të shkresës së sipërcituar, rezulton se nëse vlerësimi social-ekonomik i kryer nga NJMF/administrator shoqëror nuk parashtron përmirësim të kushteve të familjes biologjike, prindi nuk lejohet të marrë qoftë edhe përkohësisht fëmijën e tij nga Qendra e Përkujdesit. Në këtë kontekst, Komisioneri vlerëson se nuk mund të ndalohen prindërit të marrin përkohësisht fëmijët e tyre, që jetojnë në qendër rezidenciale, nëse nuk provojnë dot përmirësim të gjendjes së tyre social-ekonomike. Në raste të tilla, Komisioneri vlerëson se vendimarrja duhet bërë rast pas rasti dhe jo të jetë e parashikuar në mënyrë kategorike.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në paragrafin 3, të nenit 36, të Kodit të Procedurës Civile, si dhe në nenin 1, nenin 20, pikën 1, të nenit 21, gërmën a), të pikës 1, të nenit 32, si dhe në pikën 10, të neni 33, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ,

V E N D O S I:

1. Pushimin e shqyrtimit të ankesës nr. 75, datë 26.07.2016, së Znj. N. B., pasi çështjet e parashtruara nga ankuesja para Komisionerit, janë gjykuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër.
2. Rekomandohet që Shërbimi Social Shtetëror të marrë masa për rritjen e fleksibilitetit, lidhur me trajtimin e rasteve, ku prindërve iu ndalohet të marrin përkohësisht fëmijët e tyre, nga Qendrat e Përkujdesit, pavarësisht se janë kujdestarë ligjorë të tyre, nëse vlerësimi social-ekonomik i kryer nga NJMF/administrator shoqëror nuk parashtron përmirësim të kushteve të familjes biologjike.

3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve, duke filluar ky afat nga dita e nesërme e komunikimit të këtij vendimi.

KOMISIONERI

IRMA BARAKU

Fusha – te mira e sherbime
Shkak - raca